REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.01.2023)

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}. (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 22.12.2022).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:39 dhe mbaroi në orën 11:49.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

4. Staf nga administrata e KLGJ-së.

5. Të tjerë: Besar Likmeta, Birn; Paola Ndroqi, Universiteti "Epoka".

6. Mimoza Koçiu, ILD.

7. {...}, Inspektorë pranë Njësisë së Inspektorëve në ILD.

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}. (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 22.12.2022).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, në këtë mbledhje do merren në shqyrtim katër çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit.

Çështja e parë ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime mbi rendin e ditës, fillojmë me çeljen e seancës dëgjimore.

Ftojmë palët!

(Futen në sallën e mbledhjes inspektorët znj. {...} dhe z. {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, të pranishëm janë përfaqësuesit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ndërkohë që nga magjistrati jemi vënë në dijeni lidhur me

raportin e depozituar, që është në pamundësi për të qenë pjesëmarrës/palë në këtë seancë, është në pamundësi shëndetësore. Është raporti i lëshuar nga komisioni mjekësor, me nr. regjistri 4, datë 06.01.2023, kopje e së cilës do t'ju vihet edhe juve në dispozicion. Rezulton që zoti {...} është në paaftësi, duke filluar nga data 5 janar deri në datën 20 janar 2023.

Kështu, në këto kushte, për shkak të njoftimit që na ka ardhur, nga ana e relatorit?

Ridvan Hado: Mendoj që të shtyjmë seancën dëgjimore dhe ta lëmë për një datë tjetër dhe konkretisht për në datë 13 shkurt, ora 11:00.

Naureda Llagami: Nga përfaqësuesit?

Marsela Pepi: Faleminderit Kryetare!

Edhe ne mendojmë që është shkak i arsyeshëm i mosparaqitjes në seancë nga ana e magjistratit. Kërkojmë të pranohet kërkesa, të shtyhet seanca. Dakord edhe për datën e planifikuar nga ana juaj.

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit!

Seanca dëgjimore shtyhet për t'u zhvilluar me datë 13 shkurt, ora 11:00.

Faleminderit për prezencën!

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.01.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2023", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:39 dhe mbaroi në orën 11:49.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

4. Staf nga administrata e KLGJ-së.

5. Të tjerë: Besar Likmeta, Birn; Paola Ndroqi, Universiteti "Epoka".

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2023", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në çështjen e dytë, e cila ka të bëjë me përbërjen Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari, për vitin kalendarik 2023.

Siç parashikon ligji, Këshilli është i detyruar që çdo vit të ngrejë një Komision për shqyrtimin e të gjithë vendimeve që Inspektori i Lartë i Drejtësisë jep për arkivimin e ankimit ose për pushimin e hetimit. Ky Komision, siç e detyron edhe ligji, është një Komision i cili ka në përbërjen e tij dy anëtarë që janë jogjyqtarë dhe një gjyqtar, dhe anëtarë zëvendësues respektivisht një gjyqtar dhe një jogjyqtar.

Komisioni sipas procedurës, parashikohet të ngrihet përmes mekanizmit të shortit, kështu që unë do të ftoja administratën.

Gjithashtu, më lejoni, pasi kam vlerësuar edhe ngarkesën e anëtarëve të Këshillit për shkak të angazhimeve që ka Këshilli në këto momente, siç është procesi i hartimit akteve të hartës gjyqësore, gjithashtu procesi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe procesi i rivlerësimit kalimtar, do të sugjeroja që anëtarët znj. Brikena Ukperaj, znj. Marçela

Shehu, z. Dritan Hallunaj të mos përfshihen në procedurën e hedhjes së shortit nga ana e gjyqtarëve. Gjithashtu, nga ana e anëtarëve jogjyqtar, sugjeroj që mos të përfshihet znj. Fatmira Luli për shkak të angazhimeve.

Nëse ky propozim pranohet nga Këshilli, unë do të sugjeroja pastaj administratën të bënte gati shortin.

Jeni dakord me propozimin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Ftoj administratën.

Procedura e shortit si më poshtë:

Fillimisht futen me radhë në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e anëtarëve jogjyqtarë: z. Aban Toro; z. Ilir Rusi; znj. Yllka Rupa.

Në enën tjetër të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e anëtarëve gjyqtarë: z. Klodian Kurushi; znj. Irena Plaku; z. Ridvan Hado.

Procedura e përzgjedhjes si më poshtë:

Nga shorti, nga anëtarët jogjyqtarë përzgjidhen: z. Ilir Rusi, z.Alban Toro.

Nga shorti, anëtari zëvendësues nga anëtarët jogjyqtarë përzgjidhet znj. Yllka Rupa.

Nga shorti, nga anëtarët gjyqtarë përzgjidhet: z. Irena Plaku.

Nga shorti, anëtari zëvendësues nga anëtarët gjyqtarë përzgjidhet: z. Klodian Kurushi.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit, pasi hodhëm shortin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro. *(Vota e zotit Hallunaj nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit: "... vota ime është pro!". E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2023, është si më poshtë:

1. Z. Ilir Rusi – anëtar;
2. Z. Alban Toro – anëtar;
3. Znj. Irena Plaku – anëtar.

Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni të Përkohshëm janë:

1. Znj. Yllka Rupa – anëtar;
2. Z. Klodian Kurushi – anëtar.

2. Komisioni ushtron veprimtarinë e tij bazuar në Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari", miratuar me vendimin nr. 200, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Ankimimet objekt i veprimtarisë së KPSHA, të ardhura deri tani dhe për të cilat nuk ka ende një vendimmarrje, dorëzohen pranë Komisionit të Përkohshëm të krijuar në pikën 1 të këtij vendimi, nga anëtari i cili nuk vijon të jetë anëtar i këtij Komisioni. Në çdo rast dokumentohet procesi i dorëzimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.01.2023)

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, të gjyqtares {...}, relatore znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:39 dhe mbaroi në orën 11:49.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

4. Staf nga administrata e KLGJ-së.

5. Të tjerë: Besar Likmeta, Birn; Paola Ndroqi, Universiteti "Epoka".

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, të gjyqtares {...}, relatore znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimet etike dhe profesionale, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 si dhe për periudhën 2017 – 2019 për gjyqtaren {...}.

Pa humbur kohë ia japim fjalën relatores zonjës Irena Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po filloj me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} gjatë periudhës së gradimit 2013 – 2016.

Procedura e vlerësimit për gjyqtaren ka filluar me vendimin me nr. 22, datë 17.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas dërgimit të dosjes me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar. Po në këtë datë është hedhur shorti dhe është zgjedhur vlerësuesi dhe nëpunësja përgjegjëse. Është njoftuar rregullisht gjyqtarja me postë elektronike lidhur me vlerësuesit. Kjo e fundit ka deklaruar se nuk ka asnjë kundërshtim si me vlerësuesit ashtu edhe me anëtarët e tjerë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me urdhrin e datës 1.02.2022 është disponuar për zhvillimin e shortit për caktimin e kategorisë së çështjeve që përzgjidhen për vlerësim etik dhe profesional, për periudhën 2013 – 2016.

Bazuar në urdhrin e relatorit, në datë 10.02.2022 është zhvilluar në Gjykatën e Lartë në mënyrë elektronike shorti për përzgjedhjen e 6 çështjeve për vlerësim, dokumentuar në procesverbalin përkatës.

Pas dërgimit të akteve që i përkasin dosjeve të përzgjedhura me short, me vendimin e datës 20.07.2022, Komisioni, pasi gjeti të plotë dokumentacionin, vendosi vijimin e procedurës së vlerësimit me qëllim hartimin e projektraportit për vlerësimin e gjyqtares {...}, si dhe njoftimin e këtij projektraporti.

Gjyqtarja është njoftuar më datë 20.09.2022. Kjo e fundit, nëpërmjet e-mailit të datës 30.09.2022 ka konfirmuar marrjen dijeni për projektraportin, duke shprehur dakordësinë lidhur me projektraportin, por ka paraqitur një kundërshtim lidhur me kriterin e fundit, konkretisht, "Aftësitë personale dhe angazhimin profesional", për sa i përket treguesit "Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë", duke kërkuar pikëzimin e saj nga 3 në 5 pikë, duke paraqitur edhe provat përkatëse, të cilat do analizohen në momentin e duhur.

Burimet e vlerësimit të përdorura për hartimin e këtij projektraporti janë:

Formulari i vetëdeklarimit të gjyqtarit;

Të dhënat e dosjes personale të gjyqtarit;

Të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, ku ka rezultuar se gjyqtarja {...} ka qenë për një periudhë rreth 5 muaj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, në fakt më pak se 5 muaj (nga data 23.01.2014 – 10.04.2014) dhe më pas si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, periudhë e cila është marrë për vlerësim duke qenë se ka periudhën më të gjatë të vlerësimit;

Dokumentet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim;

Dokumentet ligjore të administruara për shkak të ankesave;

Të dhënat në pjesëmarrje në aktivitete trajnuese;

Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Po kaloj tek kriteret e vlerësimit për ndihmësmagjistraten.

Kriteri i "Aftësisë profesionale të ndihmësmagjistratit", "Njohuritë ligjore", "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm ose konfliktin e

normave". Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, është arritur në konkluzionin sa i përket pasqyrimit të ecurisë procedurale të çështjes, si një element thelbësor për ta bërë të kuptueshme, por edhe të qartë natyrën e çështjes së shtruar për zgjidhje para Kolegjit përkatës të Gjykatës së Lartë, rezulton kujdesi i ndihmësmagjistrates për të pasqyruar qartë dhe me saktësi ecurinë procedurale të çështjeve, posaçërisht në ato raste kur çështja vjen para Gjykatës së Lartë si pasojë e një procesi rishikues, pas disponimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në lidhje me identifikimin e natyrës së mosmarrëveshjes – Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti dhe rrethanat e çështjes të përshkruara në pjesën hyrëse të relacionit si dhe shkaqet e rekursit, pavarësisht se nuk rezulton të jetë përcaktuar në mënyrë deklarative nga ndihmësmagjistratja në rekurset e analizuara. Identifikimi dhe përshkrimi i qartë dhe konciz i fakteve të çështjes, ecurisë procedurale të gjykimit dhe veçanërisht të shkaqeve të rekursit, sjell si pasojë identifikimin e saktë të çështjes dhe përcakton natyrën specifike të çështjes sipas objektit të saj (Çështje penale themeli, kërkesë gjatë fazës së ekzekutimit, kërkesë për rishikim vendimi) si dhe lëndën e shqyrtimit nga Kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë në drejtim të aplikimit të ligjit procedural dhe/ose material penal.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm dhe konfliktit të normave rezulton përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes dhe evidentimi i qartë i natyrës së shkaqeve të rekursit, nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës/kolegjit dhe shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar dokumenteve ligjore rezulton se ndihmësmagjistratja në çdo rast ka identifikuar dhe referuar ligjin e zbatueshëm, në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor.

Sa i përket evidentimit të konfliktit të normave, në një nga dokumentet ligjore të analizuara rezulton të jetë evidentuar dhe vendosur përballë njëra-tjetrës si pjesë e arsyetimit të mendimit të ndihmësit ligjor, parashikimet e neneve 78 dhe 82 të Kodit Penal, në lidhje me figurën e veprës penale të "Vrasjes me dashje" në raport me atë të "Vrasjes në kushtet e tronditjes së fortë psikike", duke bërë dallimin mes elementëve të anës objektive dhe posaçërisht të asaj subjektive të këtyre dy veprave penale, në funksion të vlerësimit mbi kualifikimin e faktit penal.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka shfaqur aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, konciz, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes, paraqitjen e tyre në mënyrë të integruar me provat e administruara, pasqyrimin e ecurisë procedurale të çështjes në gjykatat e faktit, duke integruar në këtë pjesë të relacioneve arsyet thelbësore të arsyetimit të këtyre gjykatave, vetëm lidhur me atë pjesë të vendimit që lidhet me shkaqet e rekursit, veçanërisht në rastet kur qëndrimi i gjykatave është i ndryshëm.

Sa i përket identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në rastin konkret, në aktet e analizuara referohet norma procedurale penale në lidhje me shkaqet e rekursit dhe mungesën e elementeve të pavlefshmërisë absolute të vendimeve të ankimuara, ndërsa sa i përket ligjit material të zbatueshëm, ai identifikohet dhe referohet në shumicën e akteve të analizuara, përveç ndonjë rasti specifik kur shkaqet e rekursit konsistojnë në drejtim të fakteve të çështjes dhe jo zbatimit të ligjit. Në vlerësimin e këtij treguesi konsiderohen edhe konkluzionet lidhur me vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nga analiza e të cilëve rezulton shkallë shumë e lartë kujdesi e gjyqtares për të përshkruar në mënyrë të qartë, koncize dhe të plotë faktet e çështjes, për të identifikuar dhe përcaktuar qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes dhe për të identifikuar ligjin e zbatueshëm, si në lidhje me aspektet procedurale ashtu edhe ligjin material në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” duhet të vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit “Aftësia për të interpretuar ligjin në çështjet ligjore materiale dhe procedurale, për të cilat i kërkohet përgatitja e analizës apo opinionit ligjor”, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se znj.{...}, si në cilësinë e ndihmësit ligjor ashtu edhe në cilësinë e gjyqtares, ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistonte, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete, në mbështetje të opinionit ligjor në lidhje me

zgjidhjen e çështjeve konkrete të ngritura në rekurs apo në funksion të zgjidhjes së çështjes në vendimet gjyqësore burim vlerësimi. Evidentohet kujdesi i saj për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor. Parimet e përdorura në interpretimin e ligjit dhe zbatimin e së drejtës, integrohen në arsyetim në funksion të konkluzioneve/ opinionit mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin "Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes" është "shumë e lartë" duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit "Arsyetimi ligjor", "Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor", në tërësi, nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja tregon kujdes të posaçëm për pasqyrimin qartë, konciz dhe të saktë të fakteve të çështjes, ecurisë procedurale të gjykimit, shkaqeve të rekursit dhe në arsyetimin ligjor të opinionit të saj drejtuar Kolegjit. Në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor, rezulton e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të koncizitetit dhe kuptueshmërisë së mendimit të ndihmësit ligjor lidhur me zgjidhjen e çështjes apo evidentimin e çështjeve për diskutim para Kolegjit. Edhe në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin, koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor" duhet të vlerësohet "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket treguesit "Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentit ligjor", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se ndihmësmagjistratja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të dokumentit ligjor, pavarësisht përmbajtjes që ka secila ndarje. Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike e rrjedhshmërisë së mendimit juridik, nga njëra pjesë e dokumentit ligjor në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin. Po ashtu, në vendimet gjyqësore burim

vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin "Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentit ligjor" është "shumë e lartë" dhe duhet të pikëzohet me 10 pikë.

Sa i përket treguesit "Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik", në tërësi, në dokumentet ligjore të analizuara, analiza ligjore dhe shkalla e argumentimit pavarësisht se në masë të ndryshme, kushtëzuar na natyra komplekse ose jo e çështjes, rezulton e lartë. Evidentohet aftësia e ndihmësmagjistrates për të ekstraktuar dhe analizuar aspektet thelbësore në lidhje me shkaqet e ngritura në rekurs si dhe dhënia e argumenteve të plota dhe koncize lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural mbi këto fakte si dhe aftësia e saj për të evidentuar çështjet ligjore që duhet të vlerësohen nga Kolegji. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së ndihmësmagjistrates, e vlerësuar kjo bashkë me mendimin e kolegjit për vlerësimin e punës së saj në hartimin e projektvendimeve gjyqësore për çështjet e relatuara, vlerësoj se aftësia e saj për këtë tregues duhet të vlerësohet "shumë e lartë". Në pikëzimin e këtij treguese, konsiderohen edhe konkluzionet lidhur me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik në katër vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në të cilat rezultoi se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në këtë drejtim. Analiza dhe argumentimi logjik në vendimet gjyqësore përgjithësisht ndjek rregullin: fakt – normë – çështje – interpretim – konkluzion dhe argumentimi logjik ka vijueshmëri duke u evidentuar interpretimi individual i ligjit nga ana e saj. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor.

Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates për treguesin "Cilësia e analizës dhe argumentit logjik" duhet të vlerësohet "shumë e lartë" duke e pikëzuar me 25 pikë.

Në tërësi, për sa i përket kriterit "Aftësia profesionale e ndihmësmagjistratit", propozoj nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe pikëzimin me 100 pikë.

Sa i përket kriterit “Aftësia organizative e ndihmësmagjistratit”, konkretisht për treguesin sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore, për arritjen e përfundimit për këtë tregues është marrë në konsideratë numri i çështjeve afërsisht të përgatitura nga ana e ndihmësmagjistrates gjatë periudhës së vlerësimit, konkretisht nga data 11.04.2014 deri në datën 20.06.2016, në një kohëzgjatje përafërsisht rreth 26 muaj, ajo ka përfunduar 619 çështje për relatim.

Në total për gjithë periudhën si më sipër, rezulton të ketë përgatitur 619 çështje ose rreth 26 (25.57) çështje në muaj.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka përgatitur për relatim mesatarisht rreth 26 çështje në muaj, duke tejkaluar mesatarisht me 6 çështje ose me 30 % standardin sasior në fuqi prej 20 çështjesh në muaj.

Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë për treguesin sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore, rezulton “mbi standard” dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore të çështjes”, referuar standardit sasior në fuqi, në periudhën e vlerësimit, ndihmësmagjistratit duhet t’i jenë caktuar për trajtim (përgatitje për relatim) së paku rreth 20 çështje në muaj, pra në total për periudhën e ushtrimit të funksionit të ndihmësit ligjor prej 24 muaj e 10 ditë (afërsisht 24.3 muaj), duhet ti jenë caktuar 486 çështje. Rendimenti i matur si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (619 çështje) me ato të caktuara, si më sipër, në këtë rast rezulton 127 % që sipas metodologjisë përkon me 15 pikë.

Pavarësisht analizës së mësipërme statistikore, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga analiza logjike e gjithë ngarkesës së punës së ndihmësmagjistrates, vlerësohet se pikëzimi për këtë tregues duhet të jetë 15 pikë, pasi ajo rezulton se ka tejkaluar standardin sasior dhe rezulton me një rendiment prej 127 %.

Sa më sipër, për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Respektimi i standardeve minimale kohore”, në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në mungesë të standardeve minimale kohore të miratuara brenda të cilave duhet të përgatitej dokumenti ligjor nga ndihmësmagjistrati në periudhën e vlerësimit si dhe në pamundësi të

përllogaritjes së kohës mesatare të përgatitjes së relacioneve për 10 çështjet e analizuara, vlerësoj se aftësia e ndihmësmagjistrates në këtë tregues është "shumë e lartë" dhe duhet të pikëzohet maksimalisht me 15 pikë.

Sa i përket treguesit "Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje të përgatitur për relatim", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në mungesë të standardeve minimale kohore të miratuara brenda të cilave duhet të përgatitej dokumenti ligjor nga ndihmësmagjistratja për periudhën e vlerësimit si dhe pamundësisë objektive të përllogaritjes së kohës mesatare të përgatitjes së relacioneve për 10 çështjet e analizuara, vlerësoj se aftësia e ndihmësmagjistrates në këtë tregues është "shumë e lartë" dhe duhet të pikëzohet me 20 pikë.

Sa i përket treguesit "Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor", edhe për këtë tregues, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi dhe mungesës së të dhënave konkrete lidhur me veprimet procedurale të kryera nga ndihmësja ligjore në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit në funksion të organizimit të procesit gjyqësor për çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, vlerësoj se aftësia e saj për këtë tregues është "shumë e lartë" dhe propozoj pikëzimin e saj maksimalisht me 15 pikë.

Sa i përket treguesit "Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relatim, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi, për shkak të kërkesave procedurale", nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se nga 10 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton vetëm një çështje e cila duhet të trajtohej me përparësi për shkak të afatit ligjor, konkretisht çështja që i përket shtetasit D.M., me objekt "Vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi", rezulton se është shqyrtuar në dhomë këshillimi për një afat deri në 8 ditë. Po ashtu çështja është caktuar dhe shqyrtuar në dhomë këshillimi brenda 8 ditëve nga momenti i regjistrimit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh të parashikuar në nenin 249, pika 10 të K.Pr.Penale.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi dhe vlerësimeve të Kolegjit, rezulton se ndihmësja ligjore ka treguar aftësi shumë të larta në evidentimin dhe përgatitjen për relatim të të gjitha çështjeve për të cilat ligji procedural ka parashikuar afate ligjore shqyrtimi. Për

këtë arsye vlerësohet se aftësitë e saj për këtë tregues janë shumë të larta dhe duhet të pikëzohen maksimalisht me 10 pikë.

Për sa i përket treguesit “Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësore”, në tërësi, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjes gjyqësore janë në çdo rast të rregullta, të sakta dhe të plota, duke përfshirë edhe relacionin e hartuar nga ndihmësja ligjore dhe çdo akt që i përket fashikullit të Gjykatës së Lartë. Shkalla e kujdesit të ndihmësmagjistrates është e lartë si në drejtim të përmbajtjes së fashikullit, të renditjes së akteve të dosjes dhe të materialeve të tjera me qëllim që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, ashtu edhe në drejtim të mbikëqyrjes së procesit administrues të dokumentacionit në dosje, duke i dorëzuar aktet e përgatitura prej saj dhe duke i administruar ato në fashikullin e gjykimit. Për këtë arsye, vlerësoj se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në lidhje me këtë tregues është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 10 pikë.

Në tërësi, sa i përket kriterit “Aftësia organizative e ndihmësmagjistratit”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë.

Sa i përket kriterit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, konkretisht për treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja, gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë, ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistratja ka shkallë “shumë të lartë” të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion dhe propozohet pikëzimi i saj me 35 pikë.

Sa i përket treguesit “Integriteti”, konkretisht nënkriterit “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, referuar burimeve të vlerësimit, konkretisht vendimit të KPK-së, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e ndihmësmagjistrates. Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e integritetit e ndihmësmagjistrates në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 40 pikë.

Sa i përket treguesit “Paanësia”, konkretisht nëntreguesit “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose

përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistratja ka shkallë "shumë të lartë" të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe propozoj pikëzimin e saj me 10 pikë.

Sa i përket treguesit "Numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari", referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit nga 10 çështjet të cilat ka rezultuar që janë marrë në shqyrtim nuk rezulton asnjë e dhënë që të jetë paraqitur kërkesë për heqje dorë. Rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari në periudhën e vlerësimit. Për këto arsye, për këtë tregues, vlerësoj se numri i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari është i pa konsiderueshëm dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Në tërësi, propozimi për nivelin e vlerësimit "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale" është "Shkëlqyeshëm" dhe pikëzimi me 100 pikë.

Sa i përket "Aftësisë personale dhe angazhimi profesional", konkretisht në treguesin "Komunikimi i qartë dhe transparent", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka komunikim të qartë dhe transparent në komunikimin verbal si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin "Komunikimi i qartë dhe transparent" është "e lartë" duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit "Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale", referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se ndihmësmagjistratja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Për këtë arsye, për sa i përket treguesit "Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale", vlerësohet se aftësia e saj është "shumë e lartë" dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Sa i përket treguesit "Aftësia për të bashkëpunuar", konkretisht nëntreguesit "Gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave

burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të ndihmësmagjistrates me kolegët, vlerësohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të bashkëpunimit dhe ndërveprimit me ta. Për këtë arsye propozohet pikëzimi i saj me 10 pikë.

Sa i përket nëntreguesit "Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të gjykatës", referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e ndihmësmagjistrates në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga organet drejtuese të gjykatës, vlerësoj se aftësia e saj në lidhje me këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates për këtë tregues duke qenë se rezulton angazhimi dhe kontributi i saj konkret, duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Sa i përket "Aftësisë për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues vlerësohet se shkalla e bashkëpunimit dhe aftësia për të reaguar me efikasitet në rast nevoje për ndihmësmagjistraten {...} është "shumë e lartë" dhe duhet të pikëzohet maksimalisht me 10 pikë.

Për sa i përket "Gatishmërisë së gjyqtarit (*ndihmësmagjistrates)* për t'u angazhuar në veprimtari të tjera", konkretisht "Pjesëmarrja e gjyqtarit (*ndihmësmagjistrates)* në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale", referuar raportit analitik të rivlerësimit rezulton se gjyqtarja, ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese si më poshtë:

(i) në cilësinë e pjesëmarrësit, në 16 aktivitete trajnuese, pjesë e Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të zhvilluara në periudhën kohore 18.11.2013-14.06.2016, gjithsej 28 trajnime;

(ii) në cilësinë e lehtësueses në 3 aktivitete trajnuese të zhvilluara në datat 14-15 janar 2016, 3-4 mars 2016 dhe 13-14 qershor 2016, gjithsej 6 e shpërndarë në ditë.

Sa më sipër rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 19 aktivitete të formimit profesional të llojit trajnime, brenda programit të formimit vazhdues, të cilat kanë zgjatur në total 40 ditë.

Konkluzioni: Referuar të dhënave si më sipër, rezulton se ndihmësmagjistratja ka marrë pjesë në 19 aktivitete trajnuese, brenda programit të formimit vazhdues të

Shkollës së Magjistraturës, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 40 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve ligjorë sipas parashikimeve të nenit 5, pika 3 , të ligjit nr.96/2016, propozoj vlerësimin e saj me 20 pikë.

Sa i përket "Disponueshmëria e ndihmësmagjistrates për trajnimin e gjyqtarëve", siç u theksua më sipër, rezulton se ndihmësmagjistratja është angazhuar në cilësinë e lehtësueses në aktivitete trajnuese në tre aktivitete trajnuese e shpërndarë në 6 ditë.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, të gjithë ndihmësmagjistratët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për ndihmësmagjistraten, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësuesit në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Sa i përket treguesit "Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë", referuar raportit analitik të rivlerësimit, akteve të vlerësimit të Kolegjit, dosjes personale të gjyqtares dhe formularit të vetëdeklarimit për aftësitë profesionale nuk rezultojnë të dhëna që znj.{...}, në periudhën e vlerësimit që përfshin vitet e plota 2013-2016, të ketë marrë pjesë në disa aktivitete, të cilat vlerësohen si veprimtari ndërinstitucionale, që kanë pasur si qëllim shkëmbimin e eksperiencave në fusha të ndryshme të së drejtës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit, vlerësoj se për ndihmësmagjistraten ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Siç e theksuam më sipër, nga ana e ndihmësmagjistrates, lidhur me këtë tregues, janë paraqitur kundërshtime, duke pretenduar se mund të vlerësohet edhe 2 pikë të tjera. Ajo ka sqaruar dhe ka paraqitur edhe prova, se: "... Gjatë kohës që ka ushtruar funksionin e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë kam marrë pjesë si përfaqësuese e këtij institucioni në veprimtari të forumit ndërkombëtar të organizuar nga KE me temë "Bashkëbisedimi i gjykatave nëpërmjet harmonizimit të drejtësisë kombëtare" në datat

21 dhe 22 qershor 2016. Lidhur me këtë, duke qenë se nga Gjykata e Lartë më është bërë me dije se nuk janë mbajtur evidenca, si provë po ju bashkëngjis e-mailet e skanuara, dokumentacionin, korrespondencën dhe organizatorët e takimit". Ka paraqitur edhe dokumentet përkatëse, biletat e avionit dhe bashkëbisedimin që ka pasur me e-mail.

Lidhur me këtë tregues, unë vlerësoj se angazhimi i saj në këtë forum nuk mund të vlerësohet në drejtim të treguesit "veprimtari ndërinstitucionale", pasi nuk rezulton një angazhim i drejtpërdrejtë i gjyqtares, por një angazhim i tillë do vlerësohet tek treguesi i mëparshëm që ka të bëjë me zbatimin e detyrave që i ngarkohen ndihmësmagjistratit nga organet drejtuese të gjykatës. Prandaj i qëndroj pikëzimit të saj me 3 pikë.

Sa i përket "Publikimet ligjore akademike", referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, ka rezultuar se ndihmësmagjistratja ka një publikim në vitin 2012, por ky publikim nuk i përket periudhës së vlerësimit 2013 – 2016.

Sa më sipër, për këtë periudhë vlerësohet se kjo e fundit nuk ka asnjë publikim ligjor dhe propozohet pikëzimi i saj me 0 pikë.

Në total, propozimi i nivelit të vlerësimit për treguesin "Aftësia personale dhe angazhimi profesional", propozohet "Shkëlqyeshëm" me pikëzimin 93 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit propozohet si më poshtë:

Aftësitë profesionale të ndihmësmagjistratit – "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë;

Aftësitë organizative të ndihmësmagjistratit – "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë;

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë;

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm" me 93 pikë.

Në tërësi, propozimi për vlerësimin e përgjithshëm është "Shkëlqyeshëm" me 393 pikë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: : Faleminderit zonja Plaku!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutim apo propozim konkret, propozojmë që ta kalojmë në tërësi raportin e vlerësimit për magjistraten {...} për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro. *(Vota e zotit Hallunaj nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit: "... vota ime është pro!". E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.01.2023)

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017 – 2019", relatore znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:39 dhe mbaroi në orën 11:49.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

4. Staf nga administrata e KLGJ-së.

5. Të tjerë: Besar Likmeta, Birn; Paola Ndroqi, Universiteti "Epoka".

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017 – 2019", relatore znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Kalojmë tek raporti tjetër për magjistraten {...}, që i përket periudhës 2017 – 2019.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish zonjës Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Sa i përket vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...} për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019, rezulton se procedura e vlerësimit për këtë gjyqtare ka filluar me vendimin e Këshillit nr. 177, datë 29.04.2021. Në fillim është zgjedhur relatorja znj. Brunilda Kadi dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili. Lidhur me vlerësuesit është njoftuar rregullisht gjyqtarja dhe kjo e fundit nuk ka paraqitur kundërshtime. Më pas është zhvilluar shorti dhe janë administruar dosjet, aktet të cilat i përkasin këtij vlerësimi.

Më pas, për shkak të largimit të anëtares, është zëvendësuar relatorja me vendimin nr. 14, datë 17.01.2022 dhe jam zgjedhur unë si relatore për vlerësimin e kësaj procedure. Gjyqtarja është njoftuar rregullisht dhe nuk ka deklaruar kundërshtime lidhur me relatoren apo për nëpunësen përgjegjëse.

Do kaloj direkt tek analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit për propozimin e nivelit të vlerësimit për çdo kriter vlerësimi, konkretisht, sa i përket "Aftësisë profesionale të gjyqtarit", treguesi "Njohuritë ligjore", konkretisht "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave", në

mënyrë të përmbledhur po kaloj tek konkluzionet duke qenë se janë relatuar gjatë tek projektraporti i vlerësimit me të cilin janë njohur të gjithë anëtarët.

Në përfundim, në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit, është arritur në konkluzionin se spikat aftësia e gjyqtares për paraqitjen dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen ne trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave" duhet të vlerësohet "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit "Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistonte, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet një kujdes i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

Pas analizës së të dhënave lidhur me këtë tregues, propozohet aftësia e saj "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket nëntreguesit “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Pas analizës së të dhënave, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit“ është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket nëntreguesit “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, në tërësi rezulton se gjyqtarja ndjek një strukturë të caktuar të vendimit, konkretisht në pjesën përshkruese ku në pjesën hyrëse përcaktohen palët ndërgjyqëse, objekti i padisë apo i çështjes në rastet e çështjes penale, akuza, etj.

Në pjesën përshkruese është ndarë në disa nënpjesë të identifikuara me tituj duke orientuar lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Mënyra e organizimit të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek kryesisht këtë renditje: (i) procedura; ii) rrethanat e faktit së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave; iii) ligjin e zbatueshëm; iv) analizën ose vlerësimin ligjor të gjykatës lidhur me çështjen.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtares dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi: (i) kërkimin të objektit të padisë apo kërkesës (pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë), (ii) përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (deklarimin fajtor apo të pafajshëm), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (dërgimin në gjyq apo pushimin e procedimit penal), (iii) dënimin dhe masën e dënimit, (iv) llogaritjen e dënimit, (v) mënyrën e ekzekutimit të tij, (vi) disponimi mbi provat materiale, (vii) masat e sigurimit si dhe (viii) shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të mirëorganizuar të

vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, lidhur me këtë tregues, propozohet aftësia e saj "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket treguesit "Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin "Cilësia e analizës dhe argumentit logjik". Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek përgjithësisht rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor – konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Lidhur me këtë tregues, vlerësohet se aftësia e gjyqtares është "shumë e lartë", dhe propozohet pikëzimi i saj me 25 pikë.

Konkretisht, propozimi im për nivelin e vlerësimit për kriterin "Aftësia profesionale e gjyqtares" është "Shkëlqyeshëm" me pikëzim 100 pikë.

"Aftësia organizative e gjyqtarit", për treguesin "Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë", konkretisht "Respektimi i afateve ligjore". Janë marrë në analizë të gjitha të dhënat statistikore, referuar këtu edhe raporti analitik. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (deri në 5 ditë), si dhe çështjet të cilat në mënyrë të gabuar janë klasifikuar si çështje me afat ligjor, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 61 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (61 çështje),

me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (572 çështje), rezulton të jetë 10 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor.

Referuar sa më sipër, pas analizimit të të dhënave, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është "shumë e lartë", brenda marzhit nga 0-10% dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Sa i përket treguesit "Plotësimi i standardeve minimale kohore", duke iu referuar statistikave rezulton se numri total i çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor rezulton të jetë 149 çështje, ose 14% e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Kjo përqindje përkon me pikëzimin me 4 pikë. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, në përcaktimin e nivelit të vlerësimit për këtë tregues, të dhënat statistikore analizohen duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Gjyqtarja ka përfunduar në periudhën 3-vjeçare të vlerësimit ne total 1495 çështje nga të cilat 827 çështje me palë kundërshtare (civile të përgjithshme, familjare, marrëdhënie pune, penale krime, penale kundërvajtje dhe kërkesa për pushim procedimi). Gjyqtarja duhet të përfundonte jo më pak se 200 çështje (referuar standardeve të miratuara) me palë kundërshtare në vit. Rezulton se gjyqtarja e ka tejkaluar këtë standard me 38%.

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: *(i)* raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit minimal që rezulton në masën 14 %; *(ii)* faktorët që ndikojnë në zgjatjen e gjykimit referuar shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe *(iii)* tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm në masën 38%, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal, nga 4 në 5 pikë.

Sa i përket treguesit "Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje", në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin për këtë tregues, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se shumicën e kategorive të çështjeve (10 nga 11 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorisë "Familjare pa palë kundërshtare" ku standardi minimal kohor është tejkaluar me vetëm 14 ditë, çka vlerësohet tejkalim i papërfillshëm, gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues, dhe propozohet pikëzimi i saj me 5 pikë.

Sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017 – 31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1495 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1612 çështje) brenda periudhës 3-vjeçare të vlerësimit, është 93 %, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 6 pikë.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtares për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 93%, por ndërkohë rezulton se (i) ajo ka tejkaluar standardin sasior për çështjet e themelit të përfunduara me 38 %, (ii) ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh pa palë kundërshtare (671 çështje) si dhe rendimenti 93% ndodhet në limitin e pikëzimit me 6 ose 8 pikë (pasi mbi 93% pikëzohet me 8 pikë), vlerësoj se, në analizë logjike të të dhënave statistikore, duke marrë në konsideratë përqindjen e çështjeve të shqyrtuar tej standardit minimal sasior dhe ngarkesën totale në punë, gjyqtarja duhet të vlerësohet dhe pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues dhe propozohet vlerësimi i saj me 10 pikë.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimeve përfundimtare gjyqësore” – Në lidhje me këtë tregues ka rezultuar se “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”. Për këtë arsye propozohet vlerësimi i gjyqtares me 15 pikë, në kushtet kur kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Sa i përket nëntreguesit “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive”, nga tërësi e burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja për kategorinë “familjare me palë kundërshtare” rezulton se ka dy seanca; për kategorinë “penale krime” rezulton se ka 2.25 seanca; për kategorinë “penale seancë paraprake”, 1.4 seanca dhe për kategorinë “civile themeli” ka zhvilluar 4.5 seanca.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha kategoritë e çështjeve, rezulton të jetë 2 seanca gjyqësore.

Bazuar në sa më sipër, duke iu referuar këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short,

rezulton se numri mesatar i seancave është 2 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave. Për këtë arsye propozohet se duke qenë se numri i seancave është më i vogël se 3 seanca, vlerësoj se aftësia e gjyqtares është "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket nëntreguesit "Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor", në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efiçencë veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Pas analizimit të të dhënave, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Sa i përket treguesit "Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore", konkretisht "Rregullshmëria e dokumenteve gjyqësore", në tërësi rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë te numërtuar dhe shfrytëzohen me lehtësi.

Për sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 5 pikë.

"Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes", në tërësi, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve të cilat që nuk i përkasin çështjes.

Pas analizimit të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është "shumë e lartë" dhe duhet të pikëzohet me 10 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin "Aftësia organizative" është "Shkëlqyeshëm" dhe pikëzimi me 100 pikë.

Sa i përket kriterit "Aftësia në angazhimin ndaj vlerave profesionale", konkretisht treguesi "Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion", referuar të dhënave që

rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion dhe propozohet pikëzimi i saj me 35 pikë.

Sa i përket treguesit "Integriteti i gjyqtarit", "Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti", duke iu referuar burimeve të vlerësimit, edhe raportit të ILDKPI-së, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimit të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj. Për këtë arsye propozoj se aftësia e saj vlerësohet "shumë e lartë" dhe duhet të pikëzohet me 40 pikë.

Sa i përket treguesit "Paanësia e gjyqtarit", konkretisht për sa i përket nëntreguesit "Përdorim" ose jo i gjuhës diskriminuese", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Pas analizës së të dhënave rezulton se aftësia e saj për këtë tregues është "shumë e lartë" dhe duhet të pikëzohet me 10 pikë.

Sa i përket treguesit "Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit", referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit, janë paraqitur 12 (dymbëdhjetë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat 4 (katër) prej tyre janë pranuar. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 14 (katërmbëdhjetë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat janë pranuar 12 (dymbëdhjetë).

Gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar numrin e kërkesa të pranuara për përjashtim si të pakonsiderueshëm.

Referuar sa më sipër, numrit të çështjeve të gjykuara nga ana e gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit (1498 çështje), vlerësoj se numri i kërkesave të pranuara të

palëve për përjashtimin e gjyqtares është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nga 12 kërkesa të paraqitura për përjashtim, janë pranuar vetëm 4 prej tyre. Në lidhje me këtë tregues propozohet vlerësimi i saj me 15 pikë.

Në tërësi, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është "Shkëlqyeshëm", duke e pikëzuar me 100 pikë.

Sa i përket kriterit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional i gjyqtares”, konkretisht për nëntreguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent”, në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 25 pikë.

Sa i përket treguesit “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi shumë të larta në drejtim të këtij treguesi. Për këtë arsye propozoj pikëzimin e saj me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Aftësia për të bashkëpunuar”, nëntreguesi “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale”, në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë. Për këtë arsye propozohet pikëzimi i saj me 15 pikë.

Sa i përket “Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore”, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore, në funksion të krijimit të një ambienti pune harmonik dhe produktiv.

Në tërësi, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën është shumë e lartë. Për këtë arsye propozohet pikëzimi i saj me 10 pikë.

Sa i përket treguesit "Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera", konkretisht për nëntreguesin "Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale", në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit ka rezultuar se gjyqtarja është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

(i) Në cilësinë e lehtësueses në Programin e Formimit Vazhdues në 1 (një) aktivitet të zhvilluar në periudhën e vlerësimit (datë 13-14 shkurt 2017), gjithsej 4 (katër) ditë trajnimi;

(ii) Në cilësinë e pjesëmarrëses në formimit vazhdues ku ka marrë pjesë në 34 (tridhjetë e katër) aktivitete trajnuese të zhvilluara për periudhën e vlerësimit (nga data 16.02.2017 deri në datën 8.11.2019), gjithsej 59 ditë trajnimi.

Referuar sa më sipër, pasur parasysh Metodologjinë e Vlerësimit dhe referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 35 aktivitete të zhvilluara për 63 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën e vlerësimit trevjeçar. Për këtë arsye propozohet vlerësimi i saj me 20 pikë.

Sa i përket treguesit "Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional", siç e theksuam më sipër rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në cilësinë e lehtësueses në një aktivitet trajnues të zhvilluar në programin e formimit vazhdues. Bazuar në sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses, për këtë tregues, duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Sa i përket treguesit "Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë të tjera", nga analizimi i burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë të dhëna për

periudhën e vlerësimit në lidhje me angazhimin e saj në mësimdhënie. Konkretisht referua vërtetimit me nr. 277 prot., datë 19.11.2021 të lëshuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore të “Albanian University”, rezulton se znj.{...} është angazhuar si personel akademik me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko – Administrative, nga data 15.03.2018 dhe në vazhdim dhe konkretisht:

- Në lëndën “E drejtë penale e krahasuar”
- Në lëndën “E drejtë civile e avancuar”
- Në lëndën “E drejtë e detyrimeve”.

Për sa më sipër, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e gjyqtares, propozohet pikëzimi i saj me 5 pikë.

Sa i përket nëntreguesit “Publikimet ligjore”, referuar burimeve të vlerësimit, në lidhje me këtë angazhim, nuk rezultojnë të dhëna për gjyqtarin.

Sa më sipër propozohet vlerësimi i saj me 0 pikë.

Në tërësi, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, është 95 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Përcaktimi i nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit propozohet si më poshtë:

Aftësitë profesionale e gjyqtares – "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë;

Aftësitë organizative e gjyqtares – "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë;

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – 100 pikë, "Shkëlqyeshëm";

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm" me 95 pikë.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është "Shkëlqyeshëm" me 395 pikë.

Gjithashtu, bazuar në nenin 93, pika 5, të ligjit “Për statusin”, duke iu referuar të dhënave të analizuara në raportin e vlerësimit, propozohet që gjyqtarja duhet të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këtë fushë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Plaku!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim kalojmë në votimin e raportit sipas propozimit të sjellë nga relatorja.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Me kaq, ishte çështja e fundit, po e mbyllim mbledhjen për sot.

Punë të mbarë!

Faleminderit!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor